



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

EUROPRINTY, HEKURUDHËS, 10000, FUSHË KOSOVË, Kosovë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

Furnizim për Zyre

Numri i identifikimit: 212-20-7843-1-3-6 C18

Numri i brendshëm: 212 20 016 136

Ministria e Pushtetit Lokal,

15 Dhjetor 2020

Neni 1 LëndaLënda e kontratës do të jetë: **Furnizim për Zyre**1.1 Ky furnizim i mallit do të bëhet për **Furnizim për Zyre**

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi	Norma e TVSH-së	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali	Totali (me TVSh)	Totali TVSh
1	Baner ngjitës - Baner ngjitës, dimensionet gjerësia 1,57m gjatësia 1,92m , me llogo me ngjyrë teget "Ministria e Pushtetit Lokal Ministarstvo lokalne samouprave Ministry of local goverment", ngjyra e prapavisë e kaltër e hapur me hartë të Kosovës	200.00	18.00	236.00	1.00	Copë	200.00	236.00	36.00
2	Baner - Baner (me ngyrë të bardhë) me llogo MPL-së (logo ngjyrë të kaltër), dimensione 200cmX85cm, 2 deri me 3 kg, me hartë të Kosovës me shenja të Komunave.	150.00	18.00	177.00	2.00	Copë	300.00	354.00	54.00
3	Lapsa kimikë - Lapsa kimik me ngjyrë të bardhë me llogo MPL-së (logo ngjyrë të kaltër) ngjyrë shkrimi të kaltërt	1.00	18.00	1.18	50.00	Copë	50.00	59.00	9.00
4	Follder të plishit - Follder të plishit (me ngyrë teget), me llogo MPL-së (llogo ngjyrë ari), format A4	10.00	18.00	11.80	20.00	Copë	200.00	236.00	36.00
5	Fasiklla Fasiklla nga kartoni me ngjyrë teget me llogo MPL-së (logo ngjyrë ari), format A4	7.00	18.00	8.26	30.00	Copë	210.00	247.80	37.80
6	Llampa Llampë tavoline material metal – qelq; 220-240V 50Hz; Ngjyrë Oxide – Gjelbert; Dimensionet gjatësia 25 – 30 cm, gjerësia 20cm; Gjatësia e kablllos 200cm me ndërprerës.	50.00	18.00	59.00	2.00	Copë	100.00	118.00	18.00

7	Perde rolete Perde roller nga pelhura (ngjyrë krem dhe gështenjtë), me mekanizëm për hapje dhe mbyllje (poshtë-lartë) - Dritarja e parë me dimensione gjerësia 2,70cm lartësia 1,70cm - Dritarja e dytë me dimensione gjerësia 2,70cm lartësia 1,70cm - Dritarja e tretë me dimensione gjerësia 2,70cm lartësia 1,70cm - Dritarja e katërtë me dimensione gjerësia 2,60cm lartësia 1,70cm - Dritarja e pestë me dimensione gjerësia 2,60cm lartësia 1,70cm	200.00	18.00	236.00	5.00	Copë	1,000.00	1,180.00	180.00
8	Perde rolete Perde me shirita nga pelhura (ngjyrë krem), me mekanizëm për hapje dhe mbyllje (majtasë-djathëtasë) - Dritarja me dimensione gjerësia 2,70cm lartësia 1,70cm	200.00	18.00	236.00	1.00	Copë	200.00	236.00	36.00
Totali i përgjithshëm								2,666.80	

1.3 Kontrata hynë në fuqi me datën: 15.12.2020. Kohëzgjatja e kontratës është 12 muaj.

Furnizimet do të kryhen menjëher pas nënshkimit të kontratës nga Operatori Ekonomik dhe sipas kërkesës së MPL-së.

1.4 Afati kohor i performances / liferimit nuk mund të jetë më shumë se **[7]** ditë kalendarike nga data e marrjes së urdhëresës nga projek menaxheri i kontratës.

1.5 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] **[kryerjes së furnizimeve]** do të jetë: **sipas kërkesës së MPL - së nga EUROPRINTY,**

1.6 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2,666.80 €** [shëno çmimin total në shifra];
Dy mijë e gjatë qind e gjashtëdhjetë gjashtë euro e tetëdhjetë cent

[shëno çmimin total me shkrim].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës/mallit pa TVSH]

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] [shërbimeve] [punëve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [furnizimeve] [shërbimeve] [punëve].

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykatën Ekonomike në Prishtinë]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:**Ministria e Pushtetit Lokal,****Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MPL, Prishtinë****Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues**Emri dhe Mbiemri: **Shkelzen Hoxha**Titulli: **Z.V Zyrtares përgjegjës i Divizionit të Prokurimit**

Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 614

E-mail: **shkelzen.hoxha@rks-gov.net****Menaxher i prokurimit nga MPL-ja:**Emri dhe Mbiemri: **Makfire Rustolli**

Titulli: Zyrtares për kontroll



Nr. i telefonit: 038/ 200 35 257

E-mail: **makfire.rustolli@rks-gov.net****Adresa e Kontraktuesit:****EUROPRINTY, HEKURUDHËS, 10000, FUSHË KOSOVË, Kosovë****Numri i Biznesit: 810444878****Nr. i llogarisë bankare: 1110065203000151****Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik**Emri dhe Mbiemri: **Vigan Berisha**

Titulli: Menaxher

Nr. i telefonit: **038 742 136 / 049 148 266**E-mail: **PROCUREMENT@EUROPRINTY.INFO**

E hartuar në gjuhën **Shqipe**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Pushtetit Lokal		Operatorin Ekonomik: EUROPRINTY, HEKURUDHËS, 10000, FUSHË KOSOVË, Kosovë	
Emri:	Shkelzen Hoxha	Emri:	VIGAN BERISHA
Pozita:	Z.V Zyrtares Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	15.12.2020	Data:	15.12.2020
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

